



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.998/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit F...SH.P.K me NRB: ..., me seli në Lagjen Rr. ... në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Liman Musa, avokat nga Ferizaj, kundër debitorit “E...” SH.P.K., me seli në Prishtinë, rruga “...” nr....., NUI:..., të cilën e përfaqëson sipas autorizimit Zyra Ligjore Pro Juris Law Firm L.L.C., duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 573/2021 të datës 20.09.2021, të Përbaruesit Privat Besnik Aliu, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 30.01.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit E... SH.P.K, i paraqitur kundër Urdhrit Përbarimor P.nr. 573/2021 të datës 20.09.2021, të Përbaruesit Privat Besnik Aliu.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përbarimor P.nr. 573/2021 i datës 20.09.2021, i lejuar nga Përbaruesi Privat Besnik Aliu.
- III. DETYROHET debitori që në emër të shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në prapësim t’ia paguaj kreditorit shumë prej 78.00 € (shtatëdhjetë e tetë euro) në afat prej 7 (shtatë) ditësh, pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi.

A r s y e t i m

Përbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përbarimor P.nr. 573/2021 të datës 20.09.2021, me të cilin ka lejuar përbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm – Faturës nr. R43283 të datës 11.06.2021; Faturës nr. R43437 të datës

11.06.2021; Faturës nr. R43434 të datës 11.06.2021; Faturës nr.43364 të datës 11.06.2021; Faturës nr. R43253 të datës 11.06.2021; Faturës nr. R43097 të datës 11.06.2021; dhe Faturën nr. R43094 të datës 11.06.2021, duke urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri ti paguaj kreditorit shumën prej 700.00 €, me kamatë ligjore prej 8% nga data e lëshimit të faturave e deri në pagesën definitive si dhe shpenzimet e procedurës përmbare, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare në të gjitha bankat komerciale në Kosovë, dhe bartjen e shumës përkatëse tek përmbaruesi privat e pastaj në llogarinë bankare të kreditorit si dhe regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit, ashtu që të paguhet borxhi i kërkuar i kreditorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton këtë urdhër për përmbare për shkak se dokumenti në bazë të cilit është marr vendimi përmbare ose urdhri përmbare, nuk është dokument i besueshëm në bazë të LPP-së. Ka shtuar se urdhri për përmbare nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kërkesat e nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, sipas të cilit propozimi për përmbare duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar dhe datën e përmbushjes vullnetare të detyrimit e të cilat i mungojnë këtij urdhri përmbare. Më tutje ka theksuar se debitori në asnjë rast nuk i ka kundërshtuar detyrimet kontraktuale, mirëpo ka kërkuar që kreditori t'i dorëzoj faturat në mënyrë të rregullt si është e paraparë me ligj dhe në afatin paritiv debitori do t'i shlyej detyrimet monetare. I ka propozuar që të aprovohet prapësimi i debitorit, të anulohet urdhri për përmbare dhe të obligohet kreditori që t'i bartë shpenzimet përmbare në tërësi.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar se debitori nuk ka arritur që me asnjë provë materiale ti vërtetoj pretendimet e tija, dhe se qëllimi i vetëm i debitorit është vonesa dhe shtyrja e përmbaremit. Tutje ka theksuar se nuk ekzistojnë asnjëra nga kushtet për anulimin e urdhrit për përmbare, pasi që i njëjti është nxjerrë konform dispozitave të LPP-së dhe i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm ashtu siç është paraparë me nenin 29 par.1.3 të LPP-së. Më tutje ka shtuar se faturat janë dorëzuar rregullisht, janë të vulosura me çka vërtetohet se të njëjtat nuk janë kontestuar nga debitori, e po ashtu përpos pranimit të mallit dhe shërbimit debitorit ju kanë drejtuar edhe me komunikim të vazhdueshëm për përmbushjen e

obligimeve. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pabazuar prapësimi i debitorit dhe urdhri për caktimin e përbarimit të mbetet në fuqi si dhe i ka kërkuar shpenzimet në emër të përpilimit të përgjigjes në prapësim në shumën prej 208.00 €.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përbarimore (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përbarim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën nr. R43283 të datës 11.06.2021 në shumën prej 100 €; Faturën nr. R43437 të datës 11.06.2021 në shumën prej 100 €; Faturën nr. R43434 të datës 11.06.2021 në shumën prej 100 €; Faturën nr. R43364 të datës 11.06.2021 në shumën prej 100 €; Faturën nr. R43253 të datës 11.06.2021 në vlerë prej 100 €; dhe Faturën nr. R43097 të datës 11.06.2021 në shumën prej 100 €, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e

dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se urdhri për përmbarim nuk është i rregullt dhe nuk i plotëson kërkesat e nenit 38 paragrafi 1 dhe 2 të LPP-së, sipas të cilit propozimi për përmbarim duhet të ketë edhe nënshkrimin e faturës së pranuar, mirëpo gjeti se të njëjtat janë të pabazuara, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar përmbarimi mbajnë vulën e debitorit dhe nga vet fakti se personat të cilët e kanë vulosur faturën i është dhënë vula në posedim vërtetohet se të njëjtat kanë qenë të autorizuar për pranimin e faturave.

Gjykata po ashtu vlerësoi pretendimet e debitorit se propozimi për përmbarim nuk përmban datën e përmbushjes vullnetare të detyrimit dhe gjeti se të njëjtat nuk gjejnë mbështetje ligjore sepse në rastin konkret faturat i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në faturë dhe në propozimin për përmbarim siç parashihet me dispozitën e nenit 40 par 1.2 të LPP-së, i cili përcakton se: *“1.Propozimi për përmbarim në bazë të dokumentit të besueshëm duhet të përmbajë:... kërkesën që organi përmbarues ta detyrojë debitorin e përmbarimit që brenda afatit prej shtatë (7) ditësh, kurse në kontestet nga raportet ku ekziston kambiali dhe çeku brenda afatit prej tre (3) ditësh, nga dita në të cilën i dorëzohet aktvendimi ta përmbushë detyrimin bashkë me shpenzimet e caktuara...”* Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Sa i përket shpenzimeve të procedurës përmbarimore, gjykata ka vendosur në kuptim të dispozitave të nenit 463 dhe 453 të LPK-së, lidhur me nenin 17 dhe 13 të LPP-së, duke ia njohur shpenzimet e të autorizuarit të kreditorit për përpilimin e përgjigjes në prapësim dhe atë në shumën prej 78.00 € (shtatëdhjetë e tetë euro), siç është e përcaktuar me rregulloren në fuqi për tarifën e avokatëve, të datës 18.03.2017 të Odës së Avokatëve të Kosovës.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 73 par të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.998/22, datë 30.01.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimin të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.